

Raporte të ndryshme pohojnë se Rusia është duke lëshuar fosfor të bardhë vdekjeprurës mbi civilët në veriperëndim të Sirisë, në vazhden e fushatës intensive të bombardimeve ndaj ISIS-it.

Armët kimike janë të ndaluara në bazë të Konventës së Gjenevës, për shkak se ato janë shumë toksike dhe mund të djegin mishin dhe kockat.

Fosfori i bardhë, një nxitës i njohur si WP, përdoret nga ushtritë për të ndriçuar objektivat e tyre gjatë natës apo gjatë një dite në tym.

Pamje tronditëse, të postuara në Twitter tregojnë qiellin e mbushur me armë potencialisht vdekjeprurëse, duke rënë si shi mbi kryeqytetin de-fakto të ISIS-it, Raqqa, transmeton lajmi.net.

Përderisa Raqqa mund të jetë një bastion i ISIS-it, aktivistët në terren pretendojnë se civilët u vranë nga këto sulme ajrore, sulme të cilat u përshkruan si “krime lufte”.

Organizatat për të drejtat e njeriut pohojnë se sulmet ajrore të Rusisë kanë vrarë më shumë civilë se sa luftëtarë të ISIS-it.

Edhe pse pamjet nuk janë vërtetuar ende, gazetarët qytetarë nga Raqqa pretendojnë se “sulmet ajrore sot qëllonin Raqqa-në me fosfor”.